



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipal Kačanik



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



1	Data	17.01.2025	Vendi	Kaçanik
	Nj. org.		Numri	Shtro. ce
			01-104/02-1746/25	

Plani i punës së ekzekutivit të Komunës së Kaçanikut për vitin 2025

Hartoi: Zyra e Kryetarit

Shqyrton dhe miraton: Kuvendi i Komunës

Kaçanik, 2025

1. Misioni

“Ofrimi i mbështetjes për të gjithë qytetarët, investimet kapitale dhe shërbimet administrative të përditshme duke siguruar koordinim dhe bashkëpunim midis Ministrive, Komunës, Drejtorive, Zyrave, Shoqërisë Civile dhe Partnerëve tjerë në funksion të ofrimit të shërbimeve efikase ndaj qytetarëve të Kaçanikut”.

2. Vizioni

“Përsosmëri në ofrimin e shërbimeve, përfshirjen e qytetarëve, barazinë, llogaridhënien, qëndrueshmërinë, punën në grup, transparencën, sigurinë në punë dhe respektin e ndërsjellë”.

Ekzekutivi i Komunës, duke u bazuar në Statutin e Komunës së Kaçanikut, Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe Rregulloret e punës si dhe aktet e tjera ligjore, ka hartuar Planin e Punës për vitin 2025 me qëllim të përmbushjes së synimeve dhe objektivave të parashtruara për këtë periudhë kohore. Në këtë plan janë paraparë të gjitha aktivitetet që do të zhvillohen gjatë vitit 2025, të cilat aktivitete janë bashkërenduar në koordinim të plotë me Kryetarin e Komunës.

Ekzekutivi i komunës, aktivitetin e vet e zhvillon përmes 9 drejtorive komunale dhe njësisë e zyrave të cilat janë të lidhura drejtpërdrejt me zyrën e kryetarit të komunës:

- **Drejtoria e Administratës së Përgjithshme**
- **Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale**
- **Drejtoria e Arsimit**
- **Drejtoria për Buxhet dhe Financa**
- **Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit**
- **Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës**
- **Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë**
- **Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit**
- **Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit**

- **Zyra e Personelit**
- **Zyra e Prokurimit**
- **Zyra për Teknologji Informative**
- **Zyra për Barazi Gjinore**
- **Zyra për Komunitete dhe Kthim**
- **Zyra Ligjore**
- **Zyra e Inspektoratit**

Ekzekutivi i Komunës gjatë vitit 2024 do të fokusohet në këto aktivitetet kyçe:

Vazhdim i efikasitetit dhe cilësisë në punë

Vazhdim i ushtrimit të përgjegjësive dhe menaxhimit në pajtueshmëri të plotë me ligjet të cilat rregullojnë përgjegjësitë e komunës dhe në pajtueshmëri me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Statutin e Komunës dhe Rregulloret e Punës.

Rregullimi i infrastrukturës shkollore dhe shëndetësore

Ngritja e cilësisë në arsim dhe shërbimeve shëndetësore

Ofrimin e kushteve themelore për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik

Koordinimi i aktiviteteve me donatorë të brendshëm dhe të jashtëm

Përcjellja dhe menaxhimi i realizimit të projekteve

Përkushtim i shtuar në plotësimin e nevojave të qytetarëve dhe ushtrimin e përgjegjësive nga autoritetet lokale sa më afër qytetarëve

Thellimi i transparencës dhe llogaridhënia

Bashkëpunim ndërkomunal

Bashkëpunim i ngushtë me nivelet qendrore

Bashkëpunimi me Asociacionin e Komunave të Kosovës

Bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare

Bashkëpunimi me organizata joqeveritare lokale dhe qendrore

Shënimi i ngjarjeve të rëndësishme si përvjetorët e betejave, Ditës së Çlirimit të Komunës, Ditës së dëshmorëve, Përvjetorit të Pavarësisë, aktivitete rinore etj.

Drejtoria e Administratës së Përgjithshme

Aktivitetet e planifikuara	Koha dhe vendi i implementimit të aktiviteteve		Rezultatet e pritura nga aktivitetet e zhvilluara	Partnerët implementues të aktiviteteve
	Koha	Vendi		
<p><i>Misioni i Drejtorisë të Administratës së Përgjithshme është forcimi i imazhit në ofrimin e shërbimeve komunale në Qendër dhe implementimi i vazhdueshëm i inovacioneve teknologjike në shërbim të zyrtarëve publik që rritin nëfshëm efikasitetin e tyre ndaj kërkesave të qytetarëve dhe institucioneve.</i></p>				
1. Ofrimi i shërbimeve në Qendër.				
1.1 Ofrimi i shërbimeve efikase dhe në kohë në mënyrë të vazhdueshme.	Janar-dhjetor 2025.	Komunë.	Ngritja e besueshmërisë dhe transparencës ndaj qytetarëve.	Drejtoria Administratës së Përgjithshme.
1.2 Informimi i drejtë dhe i saktë si dhe aplikimi i shërbimit “One Stop Shop”	Janar-dhjetor 2025.	Komunë.	Shërbim efikas dhe ulje e vonesave nëpër sportele të palëve	Drejtoria Administratës së Përgjithshme.
2. Ngritja e efikasitetit në Qendër.				
2.1 Adresimi me kohë i të gjitha kërkesave që i'u drejtohen Administratës Komunale dhe Kuvendit Komunal.	Janar-dhjetor 2025.	Komunë.	Sistemimi i të gjitha kërkesave nga qytetarët, procedimi në drejtoritë përkatëse, shqyrtimi i tyre dhe dhënia e përgjigjeve palëve.	Drejtoria Administratës së Përgjithshme.

2.2 Sjellja e mirë ndaj palëve, dhënia e udhëzimeve dhe informimi i tyre.	Janar-dhjetor 2025.	Komunë.	Rritje e besueshmërisë të qytetarët.	Drejtoria Administratës së Përgjithshme.	
2.3 Përdorimi i sistemit të pritjes dhe menaxhimin e radhës në sportele	Janar - dhjetor 2025.	Komunë.	Eliminimi i pritjeve të gjata për shërbime komunale.	Drejtoria Administratës së Përgjithshme.	
3. Bashkëpunimin dhe organizimin e punës në Gjendjen Civile					
3.1 Përcjelljen e punës dhe të aktiviteteve të të gjithë zyrtarëve të Gjendjes Civile	Janar-dhjetor 2025.	Komunë dhe zyre të vendit.	Punë më efektive dhe rezultate edhe më të mira, duke respektuar ligjet në fuqi të Republikës së Kosovës.	Drejtoria e Administratës së Përgjithshme.	
3.2 Bashkëpunim shumë të ngushtë me ministritë përkatëse siç janë: MPB, MAP, MAPL si dhe departamenteve që operojnë në këto ministri.	Janar-dhjetor 2025.	Komunë.	Bashkëpunim të mirë me ministritë e përmendura e sidomos me MAPL konkretisht me departamentin e TI lidhur me përmirësimin e programimeve në Gjendjen Civile.	MPB,MAP,MAPL	
3.3 Raportimi i të gjithë punës së Gjendjes Civile në Komunën e Kaçanikut.	Janar-dhjetor 2025.	Komunë.	Raportet do të jenë të rregullta dhe të sakta që pasqyrojnë punën reale të këtij shërbimi.	Drejtoria e Administratës së Përgjithshme dhe MPB.	
4. Përcjellja dhe zbatimi i ligjeve në fuqi dhe ligjeve të reja					
4.1 Aplikimi i të gjitha dispozitave ligjore që dalin nga Kuvendi i Kosovës.	Janar-dhjetor 2025.	Komunë.	Do të zbatohet të gjitha ligjet dhe udhëzimet administrative që janë në fuqi në Republikën e Kosovës.	Drejtoria e Administratës së Përgjithshme dhe MPB.	

4.2 Vizita më të shpeshta në teren në Zyrat e Gjendjes Civile.	Janar-dhjetor 2025.	Komunë dhe zyre të gjendjes civile në terren.	Koordinimi të jetë më i mirë dhe zbatimi i dispozitave ligjore të jetë më i lehtë.	Drejtoria e Administratës së Përgjithshme.
4.3 Përcjellja e të gjitha ligjeve dhe udhëzimeve të reja zyrtarëve të Gjendjes Civile.	Janar-dhjetor 2025.	Komunë.	Përcjellja e njoftimeve dhe informatave tek zyrtarët e Gjendjes Civile do të bëhet me kohë.	Drejtoria e Administratës së Përgjithshme.
5. Zbatimi i kompetencave dhe autorizimeve				
5.1 Regjistrimet e lindjeve, martesave dhe vdekjes si dhe ruajtja e Akteve.	Janar-dhjetor 2025.	Komunë.	Regjistrimet e lindjeve, martesave, vdekjeve dhe të shtetësisë në sistem të Gjendjes Civile.	Drejtoria e Administratës së Përgjithshme.
5.2 Lëshuarjen e Certifikatave-dokumenteve.	Janar-dhjetor 2025.	Komunë dhe zyre të gjendjes civile në terren.	Lëshimi i të gjitha dokumenteve që janë në mandat dhe në kompetencë në afat sa më shkurtë dhe me fleksibilitet.	Drejtoria e Administratës së Përgjithshme.
5.3 Marrja e vendimeve të ndryshme.	Janar-dhjetor 2025.	Komunë dhe zyre të gjendjes civile në terren.	Angazhim në marrjen e vendimeve të ndryshme lidhur me procedurat e regjistrimeve të mëvonshme përmirësimet, ndryshimet etj.	Drejtoria e Administratës së Përgjithshme.
5.4 Mirëmbajtjen e librave bazë dhe Akteve.	Janar-dhjetor 2025.	Komunë dhe zyre të gjendjes civile në terren.	Mirëmbajtjen e akteve të lindjeve, martesave, vdekjeve dhe shtetësisë si dhe mbylljen e tyre në fund të vitit kalendarik.	Drejtoria e Administratës së Përgjithshme.

6. Zbatimi i programeve të reja në Gjendjen Civile			
6.1 Zbatimi i sistemit të unifikuar të gjendjes civile.	Janar – dhjetor 2025.	Komunë dhe zyre të gjendjes civile në terren.	Aplikimin e sistemit të unifikuar të gjendjes civile në të gjitha zyret e gjendjes civile.
7. Shërbime cilësore dhe efikase në punë			
7.1 Angazhim i veçantë në shtimin e efikasitetit të punës dhe furnizim me kohë me material hargues administrativ.	Janar - dhjetor 2025.	Komunë.	Shërbime më efikase e cilësore për qytetarët. Përkushtim i veçantë dhe shërbime efikase për bashkatdhetarët tanë.
7.2 Furnizim me kohë me material shpenzues.	Janar-dhjetor 2025.	Komunë.	Furnizimin me kohë me material shpenzues si: Certifikata apo me mjete të tjera të nevojshme për zyre e Gjendjes Civile.

8. Koordinimin dhe organizimi i punës në Arkivin Komunal			
8.1 Ruajtja, mirëmbajtja dhe sistemimi i lëndëve arkivore.	Janar-dhjetor 2025.	Komunë.	Ruajtja dhe mbrojtja e lëndëve arkivore.
8.2 Ofrimi i shërbimeve të arkivit të komunës për qytetarët si dhe arkivimi elektronik i lëndëve.	Janar-dhjetor 2025.	Komunë.	Kursimi i hapësirës fizike në objekt dhe qasje më e shpejtë, transparencë e plotë, ruajtje e sigurt e të dhënave.

9. Bashkëndimi i punës me njësinë e përkthimit				
9.1 Përkthimi i të gjitha dokumenteve që dalin nga Komuna dhe Kuvendi i Komunës, nga gjuha shqipe në gjuhën serbe.	Janar-dhjetor 2025.	Komunë.	Plotësimi i kriterëve të Ligjit për Gjuhët Zyrtare në Administratën Komunale.	Drejtoria e Administratës së Përgjithshme.
10. Organizimin e punës në sektorin teknik				
10.1 Mirëmbajtja e pastërtisë dhe gjendjes teknike të objekteve të administratës komunale.	Janar-dhjetor 2025.	Komunë.	Nivel më i lartë i pastërtisë dhe gjendjes teknike të objekteve të administratës komunale.	Drejtoria e Administratës së Përgjithshme.
10.2 Mirëmbajtja e oborrit të objektit si dhe largimi i mbetjeve të panevojshme nga depoja.	Janar-dhjetor 2025.	Komunë.	Pamje më e mirë nga jashtë. Lirimi i hapësirës në depo.	Drejtoria e Administratës së Përgjithshme.
10.3 Sigurimin e gjeneratorëve.	Janar - dhjetor 2025.	Komunë.	Mos ndërprerje e vazhdimësisë së punës si mungesë e energjisë elektrike.	Drejtoria e Administratës së Përgjithshme.

11. Organizimin e punës në sektorin e logjistikës				
11.2 Pranimi dhe dorëzimi i gjitha faturave për të gjithë sektorët.	Janar-dhjetor 2025.	Komunë.	Shërbime, futja në sistemin e faturimit etj.	Drejtoria e Administratës së Përgjithshme.
11.3 Qasja në freebalance – përpunimi i faturave për të gjithë sektorët e komunës.	Janar-dhjetor 2025.	Komunë.	Punimi i gjitha lëndëve nga prokurimi.	Drejtoria e Administratës së Përgjithshme.
11.4 Mirëmbajtja e autoparkut dhe veturave zyrtare.	Janar-dhjetor 2025.	Komunë.	Shërbime efikase dhe ulje të shpenzimeve për vetura zyrtare.	Drejtoria e Administratës së Përgjithshme.

11.5 Qasja në sistemin e e -pasurisë.	Janar-dhjetor 2025.	Komunë.	Shërbime, regjistrimi dhe barkodimi i aseteve.	Drejtoria e Administratës së Përgjithshme.	
12. Takimet me këshillat lokal					
12.1 Organizimi i takimeve me kryetarët e këshillave lokal .	Janar - dhjetor 2025.	Komunë. Teren.	Takime te rregullta me këshillat lokal sipas Udhëzimit Administrativ NR.02/2019 për Organizimin , Funksionimin dhe Bashkëpunimin e komunave me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane.	Drejtoria e Administratës së Përgjithshme. Drejtoritë tjera.	

Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

PLANIFIKIMI DHE IMPLEMENTIMI I PLANIT TË PUNËS SË QENDRËS PËR PUNË SOCIALE NË KAÇANIK PËR VITIN 2025

OBJEKTIVAT	VEPRIMET	AFATI KOHOR	KOSTOJA FINANCIARE	PËRGJEGJËSIA	REZULTATET	VËSHTËRSIT
I. ASISTENCA SOCIALE 1. Përkrahja financiare familjeve në gjendje të rëndë ekonomike, të cilat i plotësojnë kriteret dhe kushtet që i parashoh Ligji i për Skemen e Ndhimave sociale me nr. 2003/15 zbatimi në përpikëri i dhe udhëzimit administrativ me nr. 08/210	Identifikim dhe përzgjedhja e familjeve të varëfura nga nënpunësit sociale në QpS Kaçanik	I përhershëm	BKK	MPMS, DMS DSHMS, QPS-së KOMUNA	Fokusimi në grupet e cenuara duke i eliminuar të gjitha familjet e papërzgjedhshme në SNS-së du ke minimizuar gjendjen e rëndë sociale dhe përmirësimin e gjendjes të familjeve në nevojë	Mungesa e ndihmave momentale
2. Monitorimi i zyrtarëve dhe shrytëzuesve të SNS-së duke i kontrolluar dhe inspektuar edhe në teren nga komisioni i autorizuar nga QPS-ja	Mbikqyrja dhe respektimi i afatit ligjor për rastet që kanë kërkuar asistencë sociale, si dhe monitorimi më i mirë i rasteve sociale	I përhershëm	BKK	Drejtori, Udh. SAS-it, nënpunësit e SAS-it dhe shërbimi administrativ	Azhuriteti më i mirë i kërkesave të palëve , respektimi i afateve ligjore	
3. Bashkëpunimi me organet lokale, komunitetin, institucionet tjera relevante , OJQ-ët lokale , indërkombëtare si dhe donatorët e ndryshëm	Do të ketë iniciativa nga ana e jonë për takime në nivel komunal, me OJQ-ët dhe donatorët e ndryshëm me qëllim të ofrimit të ndihmave shtesë rasteve të rënda sociale	I përhershëm	BKK	Drejtori, udh. i SAS-it, institucionet relevante OJQ-ët donatorët eij.	Ofrimi i ndihmave nga të gjithë do të ndikoj në minimizimin e varfërisë së skajshme	Pjesmaria e faktorëve relevant

OBJEKTIVAT	VEPRIMET	AFATI KOHOR	KOSTOJA FINANCIARE	PËRGJEGJËSIA	REZULTATET	VËSHTËRSIT
II. SHËRBIME SOCIALE	Monitorimi dhe mentorimi lidhur me zbatueshmërinë e ligjeve dhe udhëzimeve administrative.	Nuk dihet	BKK	DSHMS, DPSF Drejtori i QPS USHS Zyrtarët shërbimeve sociale	Ofrimi i shërbimeve më të avancuara konform ligjit dhe konventave ndërkombëtoare	
1. Zbatimi i të gjitha ligjeve, rregulloreve si dhe të udhëzimeve administrative, do të jetë objektivi i QPS-së						
2. Mbrojtja e fëmijëve	1 Bashkimi familjar Edhe gjatë këtij viti do jetë bashkimi familjar për fëmijët e braktisur, natyrisht aty ku ka mundësi, ndërsa aty ku nuk egziston mundësia do të aplikohet format tjera të mbrojtjes 2. Srehim Familjar Rastet e fëmijëve pa përkujdesje prindërore do të strehohen tek të afërmit, ku për një numër të tyre do të sigurohen pagesa mujore prej 100 €, Po ashtu për raste e fëmijëve të braktisur dhe keqëtrajtuar do të jetë prioritet. Të gjithëve do t'i sigurohen strehimet familjar për një fëmijë pagesa mujore nga prej 150 €.	I përhershëm	BKK	DSHMS, DPSF QPS-së, OJQ-ët e ndryshme etj.	Mbrojtja më e mirë e fëmijëve të braktisur	Ndikimi rrethit se dhe përkrahja e familjeve të rasteve të tilla
		I përhershëm	BKK	DPSF<DSHMS, QPS Familjet strhuese	Ofrimi i shërbimeve më të mira dhe ngrohtësia familjare për fëmijët	Familjet strhuese hezitojnë të marrin fëmijë

OBJEKTIVAT	VEPRIMET	AFATI KOHOR	KOSTOJA FINANCIARE	PËRGJEGJËSIA	REZULTATET	VËSHTËRSIT
	<p>3. Birësimi (Adoptimi)</p> <p>QPS-ja lidhur me këtë kategori do të respektoj ligjet dhe udhëzimet në fuqi, Konventat ndërkombëtare etj. Detyrë permanente e zyrtarëve të SHS do të jetë gjeja e familjeve për birësimbrenda Kosovës. Pra vetëm atëherë kur shterren këto mundësi dhe kur do të jetë në interes të fëmijut do të bëhet adoptimi jashtë vendit me pëlqimin e Panelit të DPSF-së për adoptim.</p>	I përhershëm	BKK	Shërbimi social DPSF Familijet adoptuese	Zgjedhja e familjes sa më të përshtatshme do të jetë motoja e jonë.	
	<p>4. Kujdestaria</p> <p>Institucioni i kujdestarisë do të aplikohet konform ligjit në fuqi. Për fëmijët që për arsye të ndryshme kanë mbetur pa përkujdesje ,do të bëhet përpjekje që për kujdestar të caktohen të afërmit e fëmijut.</p>	I përhershëm	BKK	QPS, DSHMS Kujdestari Ligjor etj.	Një përkujdesje më e mirë për fëmijun pa përkujdesje.	

OBJEKTIVAT	VEPRIMET	AFATI KOHOR	KOSTOJA FINANCIARE	PËRGJEGJËSIA	REZULTATET	VËSHTËRSIT
	<p>5. Mbrojtja e delekuentëve të mitur</p> <p>Konform ligjit penal për të mitur QPS-ja do të qaset kësaj kategorie të të miturëve. Do të kemi një bashkëpunim me shërbimin sprovues.</p>	I përherëshëm	BKK	QPS, Shërbimi social, SHPK, Gjykatat Shërbimi sprovues, Familja e të miturit	Përmirësimi i sjelljeve të të miturëve si dhe rintepririmi i tyre në shoqëri	
	<p>6. Fëmijët e rrezikuar dhe abuzuar</p> <p>Shërbimi social do të ketë kujdesë të veçant për këtë kategori të të fëmijëve, do të ketë bashkëpunim me të gjitha institucionet relevante.</p>	I përherëshëm	BKK	QPS, Shërbimi sprovues, SHPK, gjykatat, shkollat etj.	Rintepririmi dhe risocializimi i të miturëve në shoqëri	
	<p>7. Mbrojtja e fëmijëve të prindërve të shkurorizuar</p> <p>QPS-ja si organ i kujdestarisë edhe gjatë këtij viti do ta përmbush obligimin ligjor për mbrojtjen e fëmijëve me të cilët prindërit e tyre në proces të shkurorizimit si dhe me ata prindër që kanë probleme bashkëshortore.</p>	I përherëshëm	BKK	QPS, DSHS, SHPK, Gjykatat, Strehimoret etj.	Mbajtja e kontakteve të rregulltë të të fëmijëve me prindër që janë shkurorizuar	

OBJEKTIVAT	VEPRIMET	AFATI KOHOR	KOSTOJA FINANCIARE	PËRGJEGJËSIA	REZULTATET	VËSHTËRSIT
	<p>8. Mbrojtja e fëmijëve me nevoja të veçanta</p> <p>Identifikimi i fëmijëve me nevoja me paafësi të përhershme me pagesë 120 euro</p> <p>9. Mbrojtja e personave të moshuar pa përkujdesje.</p> <p>Edhe pse kjo kategori në komunën tonë nuk është dukuri, e shpesht shërbimi social do t'iu dal në ndihmë të gjithëve konform kriterëve për strehim institucional.</p>	I përhershëm	BKK	QPS, DSHS Komisioni mjekësor Qendra e shëndet mental, OJQ-ët etj.	Për kategori do të ketë rezultate të mbarësishme nga komisioni mjekësor	
		I përhershëm	BKK	QPS, DSHM Divizioni i institucioneve familjet etj.	Trajtimi i barabartë i kësaj kategorie	
3. Mbrojtja e të rriturëve	QPS-ja në bashkëpunim me të gjitha institucionet do t'iu ofroj ndihmë të nevojshme të gjithë rasteve që kanë nevojë për rritësimin e tyre.	I përhershëm	BKK	QPS, DSHM Divizioni i institucioneve familjet etj.	Do të ketë një përkujdesje më e mirë për këtë kategori.	
4. Dhuna në Familje	Kjo kategori do të ketë prioritet edhe në këtë vit. Do të respektohen ligjet dhe rregulloret në fuqi. Për një efikasitet më të mirë, do të organizohen trajnime për personel	I përhershëm	BKK	QPS, SHPK Mbrojtësi i viktimave, Gjykatat Strehmoret OJQ-ët	Presim zvogëlim të kësaj dukurie	Mungesa e strehimoreve të përkohshme për këtë kategori.

OBJEKTIVAT	VEPRIMET	AFATI KOHOR	KOSTOJA FINANCIARE	PËRGJEGJËSIA	REZULTATET	VËSHTËRSIT
5. Trafikim i qenleve njerëzore	QPS-ja në bashkëpunim me të gjitha institucionet do t'iu ofroi ndihmë të nevojshme të gjithë rasteve që kanë nevojë.	I përhershëm	BKK	QPS, DSHS, SHPK, IOM, Gjykatat Strehimore etj. Prokuroria	Riintegrimi i rasteve të tilla në shoqëri	
III. SHERBIMI FINANCIAR						
1. Përcjellja e gjendjes financiare, si dhe kryerja e të gjitha pagesat për QPS-ën	Do të bëhet përpjekje maksimale që shpenzimet të jenë sa më të vogla	Tërë vitin	BKK	Drejtori, DSHMS financiar etj.	Shpresojm në përmbushjen e nevojave të QPS-ës	
2. Shfrytëzimi racional i mjeteve në bazë të alokimeve të lejuara	Do të shfrytëzohen mjetet të cilat	Tërë vitin	BKK	Drejtori, DSHMS	Përmirësimi i kushteve të	

Aktiviteti i planifikuar	Koha dhe vendi i implementimit të aktiviteteve		Rezultatet e pritura nga aktivitetet e zhvilluara	Partnerët implementues të aktiviteteve
	Koha	Vendi		
1. Funkionimi i shërbimeve primare shëndetësore				
1. Respektimi i orarit të punës dhe dicitlina në punë. 2. Ti kushtohet rëndësi mbajtjes se higjienës ne te gjitha objektet shëndetësore. 3. Te sigurohet qe puna te jete efektive, si dhe bashkëpunimi kolegjial te jete ne nivel dhe qe do të ishte ne interes te pacientit. 4. Të vazhdohet me aktivitetete zhvillimit te vazhdueshem profesional për mjeke dhe infermiere.	Janar–Dhjetor 2025	DSHM S, QKMF, QMF, AMF		Kryetari i Komunës, DSHMS-ja, Ministria e Shëndetësisë.
			Efikasitet në shërbime shëndetësore	DSHMS Ministria e Shëndetësisë , OIQ

<p>5. Te vazhdohet me parandalimin e semundjeve permes skriningut.</p> <p>6. Projekti per vetedjesimin e te rinjeve per semundjen e Hiv-Aids-it, si dhe ruajtjen nga semundjet seksualisht transmissive.</p> <p>7. Funkcionalizimi i sistemit informativ shëndetësor në terren(QMF dhe AMF)</p> <p>8. Vazhdimi i keshillimit me nena, gra shtatezëna, si dhe gra te reja lidhur me te gjitha aspektet e shendetit riproduktiv si dhe planifikimin familjar.</p>	<p>Janar-Dhjetor 2025</p>		<p>QKMF, DSHMS, Ministria e Shëndetësisë</p>
<p>9. Trajnimi i stafit per emergjencat mjekesore nga eksperte te Mjekesise emergjente,</p> <p>10. Te behet edukimi i pacienteve lidhur me ndryshimin e stilit te jetes sic janë :obesiteti, duhani drogat, aktivitetet fizike me çka do të behet parandalimi i shume</p>	<p>Janar –Dhjetor 2025</p>	<p>QKMF, QMF, AMF</p>	<p>QKMF</p>

<p>sëmundjeve që mund ta rrezikojnë seriozisht shëndetin.</p> <p>11. Te thellohet bashkëpunimi me komunat tjera ,ne mënyrë që te behet shkëmbimi i përvojave.</p>				
<p>13. Mundersia e lidhjes se kontratës së veçantë me specialiste të lemive te ndryshme, që i mungojnë QKMF-se qe se paku 1 deri 2 here ne jave te vijne në QKMF dhe atë me te vetmin qellim qe këto shërbime ti ofrohen qytetareve .</p>	<p>Janar – Dhjetor 2025</p>	<p>QKMF</p>	<p>Kujdese stabile shëndetësore</p>	<p>DSHMS, QKMF</p>
<p>14. Mbulimi i terrenit me mjete dhe funksionimi i rregullt i QMF-ve dhe AMF-ve.</p>				
<p>15. Kodi veshjes per personel shendetesor ,si dhe stafin tjetër ndihmes.</p>				
<p>16. Te vazhdohet kujdesi shtepijak per te semuret me kancer dhe pacientet e palevizshem.</p>				

<p>17. Te behet dezinfektimi, dezinfektimi dhe deratizimi i objekteve shendetesore, si dhe sipas mundësisë dezinfektimi, dezinfektimi i hapësirës ajrore të Komunës së Kaçanikut.</p>	<p>18. Te vazhdohet me programin per vizita shtepijake per nena dhe femije nga moshja 0-3 vjeç.</p>	<p>19. Furnizimi me barna nga lista esenciale, si dhe intervenimi i komunes ne situata kur nuk kemi furnizim nga Ministria e Shendetesise.</p>	<p>20. Faza e tretë e bashkëpunimit QKMF-AQH, fillimi i punës së këshillimores për edukim shëndetësor për sëmundjet kronike për diabet, hipertension dhe astmë bronkiale.</p>	<p>Janar – Dhjetor 2025</p>	<p>QKMF, QMF, AMF</p>	<p>Qëndrueshmëri në furnizim me barna esenciale</p>	<p>Drejtoria e Shëndetësisë Ministria e Shëndetësisë, UNICEFI, AMC-ja, Qeveria e Luksemburgut.</p>
---	---	--	---	-----------------------------	-----------------------	---	--

21. Vazhdimi i i vaksinimit te rregullt eshte i obliguar.				QKMF-DSHMS- Ministria Shendetesisë- AQH	Ministria e Shendetesisë ,Inspektorati shendetësor
22. Respektimi i ligjit per duhanin.	Janar – Dhjetor 2025	QKMF , QMF, AMF			
23. Vazhdimin e bashkepunimit me organizata qeveritare, joqeveritare te vendit dhe ndërkombëtare.	Janar – Dhjetor 2025	QKMF , QMF, AMF		Ngritja e nivelit te shërbimeve mjekësore	DSHMS, Ministria e Shendetesisë
24. Te mbahen ligjerata neper shkolla me nxënës, për sëmundje te ndryshme, si dhe të bëhen kontrollat sistematike mjekësore për nxënës të shkollës fillore.	Janar – Dhjetor 2025	QKMF , QF, AMF		Njoftimi dhe parandalimi i sëmundjeve ngjitëse	Ministria e Shendetesisë DSHMS,IKSHP
25. Te punohet sipas protokoleve dhe udhërrëfyesve klinik sipas Mjekësisë se bazuar ne dëshmi.	Janar – Dhjetor 2025	QKMF , QMF, AMF			Instituti kombëtar për Shendetësi Publike Inspektorati sanitar

26. Klasat për nena dhe fëmijë të vazhdojnë aktivitetin e tyre	Janar- Dhjetor 2025		QKMF-DSHMS-MSH-AMC	
27. Mirembajtja e pajisjeve elektroenergjetike ne QKMF.	Janar- Dhjetor 2025			
28. Servisimi i rregullt dhe mirembajtja e autoambulancave dhe veturave tjera ne QKMF	Janar – Dhjetor 2025		QKMF-DSHMS	
29. Të vazhdohet me implementimin e projektit për zvogëlimin e përshkrimit të antibiotikëve në kujdesin primar shëndetësor.	Janar- Dhjetor 2025		QKMF-ICARS-MSH	Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës
30. Dërgimi i mjekëve në specializim sipas UA 04/2020 për Kujdesin Primar Shëndetësor	Janar-Dhjetor 2025		KOMUNA KAÇANIK-MSH	

Drejtoria e Arsimit

Aktivitetet e planifikuara	Koha dhe vendi i implementimit të aktiviteve		Rezultatet e pritura nga aktivitetet e zhvilluara	Partnerët implementues të aktiviteve
	Koha	Vendi		
1- Zbatimi i Strategjisë për Arsim 2022-2026				
1.1. Furnizimi me rjet të internetit cilësor dhe shtimi i pajisjeve teknologjike të nevojshme	Janar – dhjetor 2025	Komunë dhe Shkollë	Organizimi i mësimit në kushte më të avansuara përmes ofrimit të shërbimeve digjitale në fushën e arsimit dhe rritja e përdorimit të teknologjisë digjitale në shkolla	Komunë – DKA - MASHTI
1.2. Pajisja e shkollave me Tabela interaktive/ të menqura	Qershor-nëntor 2025	Shkollë	Ngritja e cilësisë në mësimdhënie dhe krijimi i kushteve më të mira për nxënërie përmes teknologjisë digjitale dhe të avansuar. Tabela elektronike/të menqura zëvendëson video projektorin dhe dërrasën e zezë.	DKA – MASHTI dhe donatorë
1.3 Hartimi i Strategjisë Komunale për Arsim 2025-2028	Janar – nëntor 2025	Komunë-DKA	Strategjia komunale për arsim për periudhën 3 vjeçare, 2025-2028, siguron arsimim cilësor gjithëpërfshirës e të digjitalizuar, harmonizim i arsimit e aftësimin profesional në përputhje me tregun e punës dhe menaxhim efikas e cilësor në përputhje me standardet ndërkombëtare.	Komunë-DKA

2- Ngritja/Avancimi i cilësisë në arsim

	Janar – dhjetor 2025	Shkollë	Zbatimi i Kurrikulës së re bërthamë e bazuar në kompetenca për nxënësit parafillor, shkollat fillore, të mesme të ulëta dhe të mesme të larta. Ngritja e kapaciteteve për sigurimin e cilësisë në të gjitha nivelet shkollore dhe përgatitja e tyre për sfidat e jetës.	Shkollë-DKA-MAShTI
2.1 Organizimi dhe struktura e sistemit arsimor; Arsimi parafillor (0), Fillor (1), Mesmë i ulët (2) dhe Mesëm i Lartë (3)	Janar – dhjetor 2025	Komunë - Shkollë	Sigurimi i cilësisë në të gjitha nivelet duke siguruar edhe një zhvillim të një sistemi funksional në përputhje me standardet ndërkombëtare. Ngritja e sistemit efikas për vlerësimin e performancës së shkollës dhe fuqizimi i organeve shkollore. Ndërtimi i mekanizmave efektivë për sigurimin e cilësisë. Avancimi i planifikimit zhvillimor në nivel shkollë dhe komune.	DKA – Shkollë, Inspektorët e Arsimit
2.3. Vlerësim i brendshëm dhe i jashtëm i procesit arsimor	Janar-dhjetor 2025	Shkollë- DKA	Mbledhja, sistemimi, evidentimi dhe raportimi i të dhënave për arritjet e nxënësve gjatë një viti shkollor	Shkollë-DKA-MAShTI (Inspektorët e arsimit)
2.4. Vlerësimi i performancës mësimdhënëse	Janar-dhjetor 2025	Shkollë- DKA	Mësimdhënia dhe të nxënit e bazuar me nxënësin në qendër dhe arritjen e kompetencave Përzgjedhja e metodologjive të përqendruara në nxënësin duke iu përshatur atyre dhe rezultateve të të nxënit	Shkollë-MAShTI Shkollë-DKA
2.5. Zbatimi i Kurrikulës Bërthamë dhe organizimi i trajnimeve për mësimdhënësit	Janar-dhjetor 2025	DKA-Shkollë	Arrija e kompetencave në 7 fushat kurrikulare: 1.Gjuhë dhe komunikim, 2.Arte, 3.Matematikë, 4.Shkenca të natyrës, 5.Shoqëria dhe Mjedisi, 6.Edukata fizike, sportet dhe shëndeti dhe 7.Jeta dhe puna. Përcaktimi i rezultateve për kompetenca dhe rezultatet e të nxënit për fusha kurrikulare të shprehura në njohuri, shkathësi, qëndrime dhe vlera që duhet të zhvillohen te nxënësit.	Shkollë-DKA-MAShTI

2.6. Zbatimi i arsimit gjithëpërfshirës	Janar-dhjetor 2025	DKA- Shkollë	Integrimi dhe ofrimi i mundësisë për përfshirjen dhe qasje të barabartë për gjithë fëmijët dhe të rinjve në arsim cilësor duke përfshirë edhe ata me nevoja të veçanta	Shkollë- DKA dhe partnerë të tjerë
2.7. Përkrahja e fëmijëve me nevoja të veçanta. Rritja e numrit të asistentëve në shkolla	Janar – dhjetor 2025	DKA - Shkollë	Krijimi i kushteve sa më të mira për këtë kategori fëmijësh, rritja e besimit dhe integritimit gradual të tyre në shoqëri dhe qasje e lirë e tyre në institucione shkollore Identifikimi i fëmijëve të cilët kanë nevojë për trajtime dhe këshillime psikologjike me qëllim të rritjes dhe përmirësimit të imazhit personal dhe angazhimi më i madh i asistentëve për fëmijë me nevoja të veçanta.	DKA – Shkollë dhe partner tjerë
2.8. Vetëvlerësimi	Janar – dhjetor 2025	Shkollë	Menaxhimi më i mirë i shkollave, krijimi i ambientit të sigurt për nxënës, ngritja e cilësisë në mësimdhënie dhe nxënje	DKA-Shkollë- Partnerë të tjerë
2.9. Orientimi në karrierë	Janar – dhjetor 2025	Qendra e karrierës SHMP Këshilltari të karrierës për klasat 6-9	Informimi, këshillimi dhe orientimi i nxënësve për karrierë. Rritja dhe zhvillimi i vetëdijes për rëndësinë e orientimit në karrierë. Orientimi i nxënësve drejt profesionit të bazuar në aftësitë dhe prijet që do të krijojë mirëqenie sociale. Njohja e vetvetes, aftësitë dhe prioritetet me qellim zgjedhjen e rrugës më të suksesshme.	DKA-Shkollë- Partnerë të tjerë
3. Organizimi i aktiviteteve të lira				
3.1. Organizimi i garave të diturisë në nivel komunal, regional dhe shtetëror	Janar – mars – prill - qershor 2025	Shkollë- Komuna tjera	Nxjtja dhe motivimi i nxënësve dhe mësimdhënësve për punë dhe njëkohësisht thellimi i njohurive në fusha të ndryshme. Po ashtu, pjesëmarrja e gjerë e nxënësve në gara ndikon edhe në ngritjen e performancës në sistemin arsimor. Përkrahja, zbulimi dhe promovimi i talentëve të rinjë.	Shkollë-DKA- MASHTI
* Olimpiada e Matematikës – gara në				

<p>nivel të shkollave, nivel komunal dhe nivel vendi</p> <p>* Olimpiada e Fizikës – gara në nivel të shkollave, nivel komunal dhe nivel vendi</p> <p>* Gara shkollore në 8 lëndë mësimore: Gjuhë Shqipe, Gjuhë angleze, Matematikë, Kimi, Fizikë, Biologji, Gjeografi dhe Histori</p>	<p>Nëntor-dhjetor 2025</p> <p>Janar – Shkurt 2025</p> <p>Maj – Qershor 2025</p>	<p>Shkollë-Gjimnazi “Skënderbeu”</p> <p>Shkollë-Gjimnazi “Skënderbeu”</p> <p>Shkollë-Gjimnazi “Skënderbeu”</p>	
<p>3.2. Garat shkollore sportive</p>	<p>Shkurt - maj-qershor 2025</p>	<p>Objektet sportive brenda komune</p>	<p>Masovizimi dhe zhvillimi i aktiviteteve sportive me qëllim të ngritjes së cilësisë në sportet shkollore dhe njëkohësisht gërshtimi i përvojave sportive dhe vetëdijësimi, motivimi e inkurajimi për zhvillimin e sporteve dhe aktiviteteve të lira në përgjithësi</p> <p>DKA - Shoqata e Pedagogëve Kulturës Fizike të</p>

4. Testi i Arritshmërisë 2025 dhe Testi i Maturës 2025

4.1. Organizimi dhe mbajtja e Testit të Arritshmërisë 2025 për klasat e nënta (IX), Testit të maturës 2025 për nxënësit maturant (XII)	Prill - Maj-Qershor 2025 dhe afati i dytë gusht 2025	Shkollë -DKA	Nxënësit semimaturantë (Testi i Arritshmërisë) dhe maturant (Testi i maturës) njoftohen me procesin e mbajtjes së testit, respektivisht vlerësimi i arritjeve, njohurive, shkathërsive dhe aftësi të nxënësve të fituara gjatë shkollimit të tyre 9 vjeçar, përkatësisht 12 vjeçar, ndërkaq pritet që afër 90 % e dy grupmoshave të kalojnë testet.	DKA-MAShTI dhe shkollat
--	--	--------------	---	-------------------------

5. Funksonimi i Organeve të shkollës – Këshillat, Aktivitet, Ekipet etj.

5.1. Ngritja e kapaciteteve të organeve të shkollës si Këshilli Drejtues i Shkollës (KDSH), Drejtori/zëvendës drejtori i shkollës, Këshilli pedagogjik (Këshilli i arsimtarëve) Këshilli i Prindërve, Këshilli i nxënësve, Aktiveve Profesionale (AP), Ekiyeve për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit (EPRBM) në arsim etj.	Janar dhjetor 2025	Shkollë-DKA MAShTI	Promovimi i mësimdhënies të fokusuar në arritjen e kompetencave kryesore dhe adresimi i nevojave të ndryshme të nxënësve, avansimin dhe zhvillimin e shkollës si dhe avansimin e të gjitha fushave të cilësisë, përmirësimin e mjedisit mësimor dhe kushteve të punës, arritjen e rezultateve në mësimdhënie e nxënie dhe përmirësimi i nivelit arsimor e njëkohësisht zvogëlimin në minimum të braktisjes së nxënësve në shkollë	Shkollë-DKA-MAShTI dhe partnerë të tjerë
--	--------------------	--------------------	---	--

6. Parandalimi i dukurive negative në shkolla

6.1. Luftimi i dukurive negative	Janar – dhjetor 2025	Shkollë DKA	Ngritja e nivelit të informimit të nxënësve për dëmet që shkaktojnë përdorimi i duhanit, alkoolit, substancave narkotike e dukurive tjera negative. Vetëdijësim dhe emancipim i fëmijëve duke përfshirë të gjitha nivelet.	DKA-Shkollë-Policia e Kosovës OJQ-të dhe partnerë të tjerë
----------------------------------	----------------------	-------------	--	--

7. Mirëmbajtja, zgjerimi i hapësirave shkollore/ndërtimi i palestrave sportive, pajisja e tyre me mjete konkretizuese

7.1 Mirëmbajtja/ Renovimi i objekteve shkollore, përgatitja e tyre për zhvillimin normal të procesit mësimor,	Qershor Gusht 2025	Të gjitha shkollat	Krijimi i kushteve më të mira në shkolla	Komuna MASHTI dhe donatorë
7.2 Vazhdimi i ndërtimit të objektit të ri shkollor në Doganaj, vazhdimi i ndërtimit të palestrës sportive në ShFMU "Idriz Seferi" në Bob dhe fillimi i ndërtimit të palestrës sportive në ShFMU "Kadri Zeka" në Dubravë, ndërtimi i aneksit në IAAP" Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka" në Kaçanik, rregullimi i hapsirave shkollore në ShFMU" Dituria" në Strazhë, fillimi i ndërtimit të ShFMU" Emin Duraku" në Kaçanik, përfundimi i ndërtimit të çerdhes së filluar në Rekë, dhe fillimi i ndërtimit të çerdhes për fëmijë në Kaçanik të Vjetër.	Janar-dhjetor 2025	Doganaj , Bob, Dubravë , Kaçanik dhe Strazhë Kaçanik i Vjetër dhe Rekë	Krijimi i kushteve më të mira në shkolla, hapësirë e mjaftueshme. Krijimi i kushteve e mundësive për zhvillimin e aktiviteteve fizike e sportive, njëkohësisht promovimin e sportistëve të rinj	Komunë-MASHTI, MZHE
8. Zbatimi i rekomandimit të MASHTI-it për strukturimin e shkollave				
8.1 Mbyllja e shkollës 4 klasëshe në Provoli	Gusht 2025	Provoli	Sigurimi i transportit dhe transferimi i nxënësve nga paralelja e ndarë në Provoli në shkollën amë, në ShFMU "Kadri Zeka" në Dubravë	DKA-MASHTI

Drejtoria për Buxhet dhe Financa

1.1. Përgatitjet fillestare për startimin e sistemit të pagesave (Free Balance) për vitin fiskal 2025.	Janar 2025	Sektori i buxhetit	Kompletimi i dokumentacionit për të gjitha programet buxhetore dhe monitorimi i tyre	DBF- MFPT. THESARI
1.2. Rregullimin e dokumentacionit për personat me autorizimet e veçanta: nëpunësi administrativ i pagesave, personi autorizues, personi aprovues, personi zotues dhe i të hyrave, certifikuesi - për vitin fiskal 2025.	Janar-Shkurt 2025	Sektori i buxhetit	Plotësimi i kërkesës për qasje të përdoruesve në SIMFK.	DBF- MFPT. THESARI
1.3. Barazimi i të gjitha shpenzimeve në sistemin e Free Balancit.	Janar-Mars 2025	Sektori i buxhetit	Përgatitja e evidencës të gjitha shpenzimeve për Programet buxhetore.	DBF- MFPT. THESARI
1.4. Përgatitja e Pasqyrave financiare të buxhetit për vitin 2023. (Raporti i realizimit të buxhetit)	31 Janar 2025	Sektori i buxhetit	Plotësimi më efikas dhe dorëzimi i pasqyrave në MEF.	DBF
1.5. Përgatitja e rrjedhës së parashë (Plan Cash-i) për të gjitha programet për vitin 2025.	Janar-Dhjetor 2025	Sektori i buxhetit	Përcaktimi i dinamikës mujore për zotimin dhe shpenzimin e mjeteve të planifikuara me BK për vitin 2015.	DBF, Ekzekutivi Komunal dhe MFPT- Departamenti i Thesarit
1.6. Barja e bilanceve të pashpenzuara nga viti 2023 në vitin 2025.	Janar-Mars 2025	Sektori i buxhetit	Shfrytëzimi me racional i HVK-ve te vitit paraprak ne vitin vijues.	DBF
1.7. Përgatitja e raportit të shpenzimeve dhe të hyrave veçjake për secilin tremujorë:	Janar-Dhjetor 2025	Sektori i buxhetit	Evidentimi i të gjitha pagesave për vitin fiskal të	DBF

(TM1, TM2, TM3, TM4 / 2025), si dhe Raportimi në Kuvendit Komunal dhe dorëzimi në MF.			shpenzimeve dhe të hyrave vetjake dhe granteve.	
1.8 Organizimi i dëgjimeve publike lidhur me hartimin e buxhetit 2026-2028 dhe dhënien e informative për shpenzimet e realizuara gjatë vitit 2025.	Qershor-Shtator 2025	Sektori i buxhetit	Ngrija e transparencës buxhetore dhe llogaridhënies.	DBF- KRYETARI I KOMUNËS
1.9. Prezantimi i Qarkores 01/2025 sipas kufijve fillestarë buxhetor dhe hartimi i buxhetit për vitin 2026 dhe vlerësimet për vitet 2027-2028 konform qarkores finale 02/2025 nga MFPT.	Maj-Korrik 2025	Sektori i buxhetit	Harmonizimi i kërkesave të drejtorive dhe futja e prioritetëve komunale sipas kufijve buxhetor.	DBF
1.10. Përgatitjet për rishikimin buxhetor si dhe propozimi për rishikimin buxhetorë 2025.	Maj-Qershor 2025	Sektori i buxhetit	Ripozicionimi i mjeteve të pashfrytëzuara gjatë periudhës dhe orientimi tek ato kode me mungese të mjeteve apo shtim të kodeve të reja-projekteve.	DBF

<p>1.11. Arkëtimi i të gjitha llojeve të pagesave në të gatshme, të realizuara përmes trezorit të Arkës së Administratës Komunale dhe nga programet e tjera buxhetore në nivel të Organizatës Buxhetore të Komunës</p>	<p>Janar-Dhjetor 2025</p>	<p>Sektori i buxhetit</p>	<p>Mbajtja e evidencave të sakta ditore, mujore dhe vjetore të arkëtimeve sipas llojit të të hyrave, sistemimi dhe depozitimi i të gjitha arkëtimeve në bankat komerciale (përgatitja e raporteve ditore, mujore dhe vjetore), si dhe barazimi reciprok me drejtoritë të cilat krijojnë të hyra)</p>	<p>DBF</p>
<p>1.12. Mbajtja e evidencës së pagave, kalkulimi i pagave për gjithë punëtorët e Organizatës Buxhetore.</p>	<p>Janar-Dhjetor 2025</p>	<p>Sektori i buxhetit</p>	<p>Mbajtja e evidencave dhe përcjellja e ndryshimeve dhe korrigjimeve për çdo muaj gjatë vitit 2025.</p>	<p>DBF, MPB – Departamenti i Pagesave dhe MF – Departamenti i Thesarit</p>
<p>1.13. Aplikimi i Petty Cashit.</p>	<p>Janar-Dhjetor 2025</p>	<p>Sektori i buxhetit</p>	<p>Realizimi i pagesave të imëta (nën vlerën 100 euro), sipas rregullave KMF.</p>	<p>DBF dhe MFPT – Departamenti i Thesarit</p>
<p>2.1. Shtypja dhe shpërndarja e faturave tatimore mbi tatimin në prone për ngarkuesen e vitit 2025.</p>	<p>Janar-Shkurt 2025</p>	<p>Sektori i tatimit në pronë</p>	<p>Njoftimi i tatimpaguesve mbi afatet lidhur me pagesën e tatimit.</p>	<p>DBF - ZKTP</p>
<p>2.2. Anketimi, rianketimi i pronave.</p>	<p>Prill-Dhjetor 2025</p>	<p>Sektori i tatimit në pronë</p>	<p>Rritja e të hyrave veçjake përmes rritjes së numrit të tatimpaguesve</p>	<p>DBF - ZKTP</p>
<p>2.3. Shqyrtimi i Rregullores së Tatimit në Pronë për vitin 2024 në territorin e Komunës së Kaçanikut.</p>	<p>Nëntor-Dhjetor 2025</p>	<p>Sektori i tatimit në pronë</p>	<p>Aplikimi i normave-tarifave të reja sipas zonave ekonomike.</p>	<p>DBF - ZKTP</p>

<p>2.4. Aplikimi i metodave – praktikave stimuluese ndaj tatimpaguesve, në veçanti aplikimi shpërblimeve përmes projekteve të komuniteteve të caktuara, të cilat realizojnë më së përafërti pagesën e tatimit karshi faturimit.</p>	<p>Janar-Dhjetor 2025</p>	<p>Sektori i tatimit në pronë</p>	<p>Rritja e të hyrave vetjake përmes realizimit me te mire të inkasimit nga ky lloj tatimi dhe përmes ngritjes së përqindjes në realizim do të rritet edhe vlera e Donacioneve nga USAID-Projekti DEMOS</p>	<p>DBF - ZKTP</p>
---	---------------------------	-----------------------------------	---	-------------------

Drejtoria e Urbanizimit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit

Aktivitetet e planifikuara	Koha dhe vendi i implementimit të aktiviteteve		Rezultatet e pritura nga aktivitetet e zhvilluara	Partnerët implementues të aktiviteteve	Buxheti	
	Koha	Vendi			Komuna	Donacione
1. Sektori i Urbanizimit						
1. Shqyrtimi i kërkesave të ndryshme që bien në natyrën e punës së këtij sektori si psh. kërkesat për leje ndërtimi, leje legalizimi, ndërtimi i destinimit të tokës - pronës, kërkesave të natyrave të ndryshme dhe dhënien e njoftimeve të ndryshme.	Janar - Dhjetor 2025	Komuna	-Lëshimi i lejeve ndërtimore, -Lëshimi Lejeve të legalizimit, -Dhënia e vërtetimeve të ndryshme, -Dhënia e Pëlqimeve të ndryshme - Dhënia e njoftimeve të ndryshme, - Lejimi i ndërtimi të destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore etj	DUKMM dhe DBZHRP.	Komuna	
1.1. Planifikimi urban dhe hapësinor						

<p>1. Përfundimi i procesit të miratimit të PZHK-se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kontrollimi i PZHK-së së Kaçanikut dhe marrja e marrja e Pëlqimit për hapjen e debatit përfundimtar publik, nga MMPHI-ja, për PZHK-në <p>2. Shqyrtimi i vërejtjeve dhe propozimeve për PZHK-ne të dalura nga debati publik, nga ana e MMPHI-se dhe dhenja e pëlqimit nga ana e tyre për aprovimin e PZHK-se për Kaçanikun, për periudhën 2025-2032.</p>	<p>Janar 2025 deri Qershor 2025-</p>	<p>Komuna MMPHI</p>	<p>Aprovimi i PZHK-se në Kuvend, fillimi i zbatimit të tij dhe krijimi i mundësisë për hartimin e Hartave Zonale.</p>	<p>Komuna (DUKMM, me drejtorite tjera dhe MMPHI.</p>	<p>Komuna</p>
<p>3. Aprovimi përfundimtar i PZHK-së nga Kuvendi i Komunës</p> <p>4. Fillimi i procesit të hartimit të Hartave Zonale</p> <p>5. Hartimi i projekteve të ndryshme për nevojat e Komunës së Kaçanikut.</p>					

	Korrik – Dhjetor 2025 Tërë viti		Fillimi i procesit të hartimit të Hartave Zonale Implementimi i projekteve të parapara me buxhet.	Komuna MMPHI Komuna, MMPHI, Donatorë				
1.2. Mbrojtja e Mjedisit								
1. Shqyrtimi i kërkesave, ankesave të ndryshme që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit, shqyrtimi i kërkesave për eksploatim të resurseve natyrore, kërkesave për Leje Mjedisore Komunale,	Janar- Dhjetor 2025	Komuna	1. Aktvendimet të ndryshme për çëshjet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit, -ndalimin e aktiviteteve që dëmtojnë mjedisin, lëshimi i Lejeve mjedisore komunale	Komuna, OJQ, Ambientalistë te rinj,	Komuna	Donatorë		

<p>2. Vetëdijesimi i qytetarëve të komunës tonë në lëmin e mbrojtjes së mjedisit,</p> <p>4. Hartimi i planeve lokale dhe rregullore komunale që kanë të bëjnë me lëmin e mbrojtjes mjedisit.</p> <p>5. Bashkëpunimi me nivelin qendror lidhur me çështjet mjedisore,</p> <p>6. Identifikimi i burimeve të ujit në komunën e Kaçanikut.</p> <p>7. Hartimi i projekteve të ndryshme nga lëmi e mbrojtjes së mjedisit,</p> <p>8. Thirrje publike për organizimin e aktiviteteve të ndryshme sipas kalendarit mjedisor.</p>		<p>-Dhënia e informatave paraprake për hulumtim të resurseve natyrore si pjesë e procesit deri në marrjen e Licencës nga KPMM,</p> <p>2. Aktvendime, Urdhëresa për ndalimin e veprimeve të ndryshme nga personat fizik dhe juridik që kanë të bëjnë me ndoçjen e ambientit, lumenjve, dëmtimin e natyrës, njoftimet e ndryshme, etj.</p> <p>3. Vendosja e shenjave në pjesë të ndryshme të Komunës –lokacione ku hedhen mbeturina për parandalimin e hedhjes së tyre.</p>	<p>KRPM “Pastërtia”,</p>	
		<p>-Shpërndarja e broshurave nga lëmia e mbrojtjes së mjedisit.</p> <p>-Mbajtja e orëve nëpër shkolla nga lëmia e mbrojtjes së mjedisit,</p> <p>-Realizimi i aksioneve për pastrimin e ambientit – shënimi i datave sipas “Kalendarit mjedisor”, etj.</p> <p>4. Takimet me MMPHI, KPMM dhe organet tjera</p>		

		<p>5. Incizimi në teren i burimeve të ujit, digitalizimi-formimi i hartave digitale për vendndodhjet e burimeve të ujit, caktimi i sasisë dhe cilësisë së ujit, në këto burime,</p> <p>6. Projekte për pastrim të ambientit, largimit të mbeturinave në tokë, lumenj dhe përroska,</p> <p>-projekte për shtimin e hapësirave gjelbëruese,</p>			
<p>1.3. Zhvillimi i turizmit në Komunën e Kaçanikut duke shfrytëzua potencialet turistike.</p>					
<p>Në bashkëpunim me Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik do të planifikohen aktivitetet për zhvillimin e turizmit.</p>	<p>Janar-Dhjetor 2025</p>	<p>Komuna Komuna</p>	<p>Tërheqja e investitorëve te mundshëm nëpër zona turistike,</p> <p>Njofimi i turistëve të ndryshëm përmes hartës turistike me lokacionet atraktive të komunës.</p>	<p>Komuna,</p>	<p>Komuna</p>
